

Mendim kundër

Unë Valbona Sanxhaktari, anëtare e trupit gjykues në procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin Gëzim Veizi me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ndaj një qëndrim ndryshe nga ai i shumicës për konfirmimin në detyrë të z. Gëzim Veizi.

Lidhur me vlerësimin e pasurisë, mendoj se analiza financiare përfundimtare e cila ka çuar trupin gjykues në përfundimin se subjekti ka mundësi financiare me burime të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve nuk ka marr në konsideratë një sër shpenzimesh të kryera nga subjekti duke i perthithur ato brenda disa shpenzimeve të tjera, e cila në vlerësimin tim e pare në një këndvështrim tjetër do e çonte subjektin në një situatë negative financiare të ndryshme, e për pasoje do të sillte pamundesin financiar për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive të tij dhe personave të lidhur. Po ashtu lidhur me krijimin e pasurisë apartament me sip.110.6m² (87.3m² funksionale) blerë në vitin 2006 me çmimin 61,000 euro, ndodhur në Rr. ***, deklaruar nga subjekti si burim krijimi: a) 20,000 euro marrë nga shitja e shtëpisë në Elbasan me kontratën nr.*** datë 12.1.2005 dhe b) 41,000 euro kredi nga banka ICB me kontratë nr.*** datë 15.12.2006, vlerësimi i kryer ndryshe nga Komisioni, lidhur me burimin e deklaruar për krijimin e pasurisë, nuk duhet pranuar pasi mbetet i paprovuar dhe vetë subjekti rivlerësimit duket se ndryshon deklarin për efekt të këtij procesi. Në vlerësimin tim nëse analiza financiare do të kish reflektuar shpenzimet korente të kryera, shpenzime mobilimi (nëse pranojmë shpjegimet e subjektit se shtëpia e vjetër u shit me mobilje, atëherë shtëpia e re kish nevojë për mobilim të plotë, sëpaku sa vlera e mobilimit të pretenduar të shitur), pagesat reale sipas kontratave për shitblerjet e pasurive të paluajtshme, ajo do të paraqiste një situatë negative financiare të ndryshme nga ajo e pranuar nga shumica në këtë vendim, situatë e cila do të sillte shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra. Në vlerësim, duhet mbajtur në konsideratë se analiza financiare që kryhet në kuadër të këtij procesi njih shpenzime bazike dhe hipotetike ndaj deklarin e subjekteve lidhur me burimin e krijimit të pasurive nuk mund dhe nuk duhet të mbulohen apo zëvendësohen lehtësisht nga të ardhura të mbetura nga analiza financiare ndër vite, e kryer në kuadër të këtij procesi.

Në lidhje me denoncimin e shtetasit Z.Gj., mendoj se ai duhet vlerësuar në vlerësimin tërsor parë në këndvështrim të nenit 61/5, të ligjit nr.84/2016, e jo në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale brenda kuadrit të kriterit profesional.

Neglizhenca e treguar nga subjekti rivlerësimit në këto çështje, moskryerja logjikisht e një sër veprimesh hetimore sipas kërkesave ligjore në shërbim të mbledhjes së provave të nevojshme për të interpretuar ligjin e për të analizuar jurisprudencën në funksion të zgjidhjes sa më të drejtë të çështjes, janë veprime të cilat krijojnë perceptimin se kanë krijuar një zgjidhje të ndryshme të çështjes në fjalë. Sëbashku me këtë çështje duhen analizuar edhe problematika dhe mangësi të vërejtura në çështje të tjera profesionale të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit, objekt shqyrtimi në këtë proces, të cilat në tërësinë e tyre duhet të vlerësoheshin në raport me cënimin e besimit ndaj publikut.

Valbona Sanxhaktari

Anëtare